

KONTRATË SHITJE KUOTASH

Tiranë më datë 28.04.2017

KONTRATË SHITJE KUOTASH

NENI 1 PALA SHITËSE

1. **Z. ZEEV VAISFELDI**, i biri i Nico, i datëlindjes 16.07.1953, lindur në Iasi Rumani dhe me banim në Itali, me adresë banimi Rruga "Via Torino 9", San Lazzaro di Savena (BO), i identifikuar nëpërmjet pasaportës Nr. YA5911481, lëshuar më datë 19.12.2013 me datë skadimi 18.12.2023, shtetas italian, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i pajisur me Kodin Fiskal Nr. VSF ZVE 53L12 Z129L, i cili zotëron në shoqërinë "Il Progetto" Sh.p.k.. 1 kuotë e cila përfaqëson 40 % të kapitalit të kësaj shoqërie, i cili përfaqësohet në këtë kontratë nëpërmjet prokurë speciale bashkëlidhur kësaj kontrate lëshuar nga Noter Giovanni PANZERA, prokurë e pajisur me Vulën Apostile Nr. 1743, datë 21.04.2017 nga **Z. Morelli CATALDO** identifikuar në këtë nen.
2. **Z. DOMENICO MINOCCHIERI**, i biri i Francesco, i datëlindjes 30.07.1953, lindur në Fontanelice, banues në Rruga "Zena", Nr. 121, Pianoro, i identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit elektronik Nr. 3899368AA, lëshuar më datë 02.10.2012 dhe me datë skadimi 30.07.2023, Komuna Pianoro, shtetas Italian, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i cili zotëron në shoqërinë "Il Progetto" Sh.p.k., 1 kuotë e cila përfaqëson 20 % të kapitalit të kësaj shoqërie, i cili përfaqësohet në këtë kontratë bashkë me miratimin e dhënë nga bashkëshortja e tij **Znj. Bisi SANDRA** nëpërmjet prokurë speciale bashkëlidhur kësaj kontrate lëshuar nga Noter Giovanni PANZERA, prokurë e pajisur me Vulën Apostile Nr. 1743, datë 21.04.2017 nga **Z. Morelli CATALDO** identifikuar në këtë nen.
3. **Z. MORELLI CATALDO**, i biri i Giuseppe, lindur në Itali në Cariati (SC) dhe banues në Itali, me adresë banimi Bolonja, Rruga "Scandellara", Nr. 48, i martuar, i datëlindjes 08.04.1967, i identifikuar nëpërmjet kartë së identitetit Nr. AU 8697834, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, i cili aktualisht ndodhet në Shqipëri Tiranë, i cili ka hyrë nëpërmjet pikës kufitare Rinas sot më datë 28.04.2017, i cili zotëron në shoqërinë "Il Progetto" Sh.p.k.. 1 kuotë e cila përfaqëson 40 % të kapitalit të kësaj shoqërie dhe përfaqëson ortakët e tjerë sipas në këtë kontratë shitje sipas prokurës speciale bashkëlidhur kësaj kontrate nga Noter Giovanni PANZERA, prokurë e pajisur me Vulën Apostile Nr. 1743, datë 21.04.2017.

NENI 2 PALA BLERËRËS

1. Shoqëria "Babasi Co" Sh.p.k., shoqëri e themeluar më datë 09.01.1998 dhe regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, shoqëri e identifikuar nëpërmjet NIPT: J74517209B, shoqëri me selit të ndodhur në Durrës, Fushë Kruje, Km 2 i Rrugës Nacionale, Fushë - Krujë Krujë, ndërtesë private, 2 katëshe, shoqëri e përfaqësuar nga ortakë dhe administratori i vetëm **Z. Pëllumb BABASI**, i biri i Bajram dhe Sabije, lindur

në Fushë Krijë dhe me banim në Tiranë, i datëlindjes 01.05.1970, i identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit elektronik Nr. 028550637 dhe Nr. Personal: H00501100K, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vperuar dhe me gjendje civile i martuar.

2. **Z. OSAMA RASHID**, i biri i Abdulmalik Rashid dhe Attia Saleh, lindur në Ramadi, Irak dhe me banim në Itali, me adresë banimi Rruga "Antonio Gramsci 10", Fiesole (FI), i datëlindjes 25.05.1953, me shtetesi Italiane, aktualisht ndodhet në Shqipëri Tiranë dhe me qëndrim në qytetin e Fushë, Krujës, me adrese Rruga "Fushë - Krujë - Krujë", Kameras, Fushë - Krujë, i cili ka hyre në Shqipëri nëpërmjet pikës kufitare Rinas më datë 28.04.2017, i identifikuar nëpërmjet pasaportës Nr. YA6992348, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
3. **Pala blerëse e identifikuar sipas këtij neni deklaron se kuotat në shoqërinë "Il Progetto" Sh.p.k. nuk do ti blejnë në bashkëpronësi por secili do të blejë kuotat e veta në pronësi të secilit prej tyre sipas përcaktimeve të kësaj kontrate.**

NENI 3 BAZA LIGJORE

Kjo kontratë harohet në bazë dhe për zbatim të: Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, bazuar në statutin e shoqërië "Il Progetto" Sh.p.k., bazuar në vendimin e shoqërisë "Il Progetto" Sh.p.k. datë 04.04.2017, prokurës speciale hartuar nga Noter Giovanni PANZERA, prokurë e pajisur me Vulën Apostile Nr. 1743, datë 21.04.2017 si dhe bazuar në vullnetin e lirë dhe të pavesuar të palëve të kësaj kontrate.




NENI 4 OBJEKTI I KONTRATËS

1. Objekti i kësaj kontrate është kalimi i pronësisë së kuotave nëpërmjet shitjes nga pala shitëse tek pala blerëse në pronësi individuale të palës shitëse sipas dhe në përputhje me kushtet dhe përcaktimet e kësaj kontrate.
2. Pala shitëse shet kuotat si më poshtë vijon:
 - a) **Z. ZEEV VAISFELDI** i shet 1 kuotë e cila përfaqëson 40 % në kapitalin e shoqërisë "Il progetto" Sh.p.k. shoqërisë "Babasi Co" Sh.p.k.
 - b) **Z. DOMENICO MINOCCHIERI**, i shet:
 - 1 kuotë e cila përfaqëson 10 % të kapitailit që ka në shoqërisë "Il progetto" Sh.p.k. shoqërisë "Babasi Co" Sh.p.k.
 - 1 kuotë e cila përfaqëson 10 % të kapitailit që ka në shoqërisë "Il progetto" Sh.p.k. Z. Osama RASHID.
 - c) **Z. MORELLI CATALDO** i shet 1 kuotë e cila përfaqëson 15 % në kapitalin e shoqërisë "Il Progetto" Sh.p.k., Z. Osama RASHID.

3. **Shoqëria "Babasi Co" Sh.p.k.** bazuar në këtë kontratë blen në pronësi individuale kuotat si më poshtë vijon:
- a) 1 kuotë nga Z. ZEEV VAISFELDI e cila përfaqëson 40 % në kapitalin e shoqërisë "Il progetto" Sh.p.k.
 - b) 1 kuotë nga Z. DOMENICO MINOCCHIERI e cila përfaqëson 10 % në kapitalin e shoqërisë "Il progetto" Sh.p.k.
4. **Z. Osama RASHID** bazuar në këtë kontratë blen në pronësi individuale kuotat si më poshtë vijon:
- a) 1 kuotë nga Z. DOMENICO MINOCCHIERI e cila përfaqëson 10 % në kapitalin e shoqërisë "Il progetto" Sh.p.k.
 - b) 1 kuotë nga Z. MORELLI CATALDO e cila përfaqëson 15 % në kapitalin e shoqërisë "Il progetto" Sh.p.k.
5. Bazuar në objektin e kontratës sipas këtij neni dhe menjëhere pas nënshkrimit të kësaj kontrate nga palët përfundimisht në shoqërinë "Il Progetto" Sh.p.k. mbeten oraktë si më poshtë vijon:
- a) Shoqëria "Babasi Co" Sh.p.k. i cili do të zotërojë 1 kuotë e cila do të përfaqëson 50 % të kapitalit të shoqërisë "Il Progetto" Sh.p.k.
 - b) Z. Osama RASHID i cili do të zotërojë 1 kuotë e cila do të përfaqësoj 25 % të kapitalit të shoqërisë "Il Progetto" Sh.p.k.
 - c) Z. MORELLI CATALDO i cili do të zotërojë 1 kuotë e cila do të përfaqësoj 25 % të kapitalit të shoqërisë "Il Progetto" Sh.p.k.

NENIN 5 ÇMIMI I SHITJES SË KUOTAVE

1. Bazuar në neni 4 të kësaj kontrate palët në marrëveshje midis tyre kanë caktuar se kuotat objekt të kësaj kontrate kanë çmimin si më poshtë vijon:
- a) kuota e cila përfaqëson 40 % të kapitalit të shoqërisë "Il Progetto" Sh.p.k. dhe që kalon pronësi sipas kësaj kontrate nga Z. ZEEV VAISFELDI tek shoqëria "Babasi Co" Sh.p.k. ka vlerën **13.200 Euro**;
 - b) kuota e cila përfaqëson 10 % të kapitalit të shoqërisë "Il Progetto" Sh.p.k. dhe që kalon pronësi sipas kësaj kontrate nga Z. DOMENICO MINOCCHIERI tek shoqëria "Babasi Co" Sh.p.k. ka vlerën **3.330 Euro**;
 - c) kuota e cila përfaqëson 10 % të kapitalit të shoqërisë "Il Progetto" Sh.p.k. dhe që kalon pronësi sipas kësaj kontrate nga Z. DOMENICO MINOCCHIERI tek Z. Osama RASHID ka vlerën **3.330 Euro**;
 - d) kuota e cila përfaqëson 15 % të kapitalit të shoqërisë "Il Progetto" Sh.p.k. dhe që kalon pronësi sipas kësaj kontrate nga Z. MORELLI CATALDO tek Z. Osama RASHID ka vlerën **4.995 Euro**.



2. Palët e kësaj kontrate deklarojnë nën përgjegjësin e tyre se pagesa për kalimin e kuotave të mësipërme janë midis tyre dhe ato nuk kanë asnjë pretendim sot dhe në të ardhmen. Pala blerëse sipas kësaj kontrate ka paguar dhe likuiduar palën shitëse për kuotat sipas përcaktimeve të nenit 4 të kësaj kontrate duke mos patur asnjë pretendim dhe/ose vërejtje sot dhe në të ardhmen mbi këtë fakt.

NENI 6 KALIMI I PRONËSISË

1. Palët e kësaj kontrate deklarojnë se kalimi i pronësisë së kuotave sipas dhe në përputhje me këtë kontratë dhe konkretisht nenin 4 bëhet menjëherë me nënshkrimin e kësaj kontrate dhe me regjistrimin e kësaj kontrate pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.
2. Palët deklarojë se me nënshkrimin dhe regjistrimin e kësaj kontrate pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit / Qendrës Kombëtare të Biznesit, pala blerëse sipas nenit 4 të kësaj kontrate fiton dhe gëzon secili të gjitha të drejtat dhe detyrimet e tij si ortak i shoqërisë "Il Progetto" Sh.p.k.
3. Pala shitëse deklaron se do ti vejë në dispozicion palës blerëse të gjitha dokumentet e nevojshme që do të kërkohen nga QKB për regjistrimin e kësaj kontrate dhe kalimin e pronësisë së kuotave sipas dhe në përputhje me nenin 4 të kësaj kontrate.
4. E drejta e pronësisë së kuotave objekti i kësaj kontrate shtrin efektet e saj në të gjitha pasurit e luajtshme dhe/ose të paluajtshme në emër të shoqërisë të tashme dhe/ose të ardhshme pa kufizim sipas pjesmarrjes së tyre në kapitalin e shoqërisë "Il Progetto" Sh.p.k.

NENI 7 DETYRIMET E PALËVE

1. Detyrimet e palës shitëse:

- a) Deklarojmë se shoqëria "Il Progetto" Sh.p.k., është e themeluar sipas ligjit në fuqi dhe aktualisht është shoqëri me status pasiv.
- b) Deklarojmë kuotat të cilat kalohen sipas dhe në përputhje me këtë kontratë janë të lira nga cdo detyrim kashti të tretëve.
- c) Deklarojmë se palës blerëse (secilit prej tyre) i kemi vënë në dispozicion të gjitha dokumentet ligjore dhe financiare të shoqërisë "Il Progetto" Sh.p.k.
- d) Deklarojmë se nuk ka subjekte dhe/ose persona të tretë që të kenë pretendime mbi kuotat e shoqërisë dhe/ose mbi pasuritë e shoqërisë "Il Progetto" Sh.p.k. duke mbajtur personalisht përgjegjësi sipas ligjit në fuqi për këtë qëllim.
- e) Deklaroj se çdo detyrim i shoqërisë "Il Progetto" Sh.p.k. është i regjistruar rregullisht në pasqyrat financiare të shoqërisë dhe nuk ka asnjë detyrim tjetër të fshehtë për të cilat ne ortakët aktual jemi në dijeni.
- f) Deklarojmë se i kemi vënë në dispozicion palës blerëse të gjithë dokumentacionin ligjor dhe/ose financiar të shoqërisë ku përfshihen të gjitha të drejtat dhe detyrimet e kësaj shoqërie si dhe bilancin dhe pasqyrat financiare të regjistruara pranë QKR/ QKB.
- g) Deklaroj se pala blerëse është njohur me aktet kryesore të shoqërisë të tilla si akti i themelimit dhe statute të shoqërisë.
- h) Deklarojmë se pala blerëse ka paguar dhe likuiduar totalisht cmimin e caktuar në nenin 5

të kësaj kontrate për pjesët e tyre takuese.

- i) Deklarojmë se me qëllim regjistrimi të kësaj kontrate pranë QKB do ti vemë në dispozicion pale blerëse të gjitha dokumentet e kërkuara nga ligji si dhe nga QKR-ja deri sa pala blerëse të marrë pronësin e kuotave sipas dhe në përputhje me neni 5 të kësaj kontrate.

2. Detyrimet e palës blerëse:

- a) Deklarojmë se blejmë kuotat e shoqërisë “Il Progetto” Sh.p.k. sipas dhe në përputhje me nenin 4 të kësaj kontrate.
- b) Deklarojmë se secili prej nesh ka paguar dhe likuiduar totalisht palën shitëse për kuotat që merr në pronësi sipas kësaj kontrate dhe konkretisht nenit 4 të kësaj kontrate.
- c) Deklarojmë se jemi njohur me të gjitha dokumentet ligjore dhe/ose financiare të shoqërisë “Il Progetto” Sh.p.k. dhe për këtë fakt skam asnjë pretendim sot dhe në të ardhmen.
- d) Deklarojmë se jemi njohur me aktivitetin e shoqërisë “Il Progetto” Sh.p.k. si dhe me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e kësaj shoqërie të regjistruar sipas ligjit në fuqi.
- e) Deklarojmë se menjherë me nënshkrimin e kësaj kontrate do të regjistrojmë këtë kontratë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit sipas procedurave ligjore në fuqi me qëllim marrjen e pronësisë.
- f) Deklarojmë se menjëherë me nënshkrimin e kësaj kontrate si dhe me regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit / Biznesit ne pala blerëse bëhemi pronarë sipas të kuotave sipas përcaktimit të nenit 4 të kësaj kontrate.



NENI 8 REGJISTRIMET

Palët vendosin se menjëherë pas nënshkrimit të kësaj kontrate pala blerëse por jo vetëm ka të drejtë të regjistrojë këtë kontratë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit brenda afateve të caktuara nga ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, ligjit Nr. Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” i ndryshuar, Ligjit Nr. 131/2015 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” i ndryshuar për fitimin e të drejtës së pronësisë së kuotave sipas dhe në përputhje me nenin 4 të kësaj kontrate.

NENI 9 DOKUMENTET E BASHKËLIDHURA

Kësaj kontrate i bashkëlidhen dhe konisderohen si pjesë e pandashme dokumentet si më poshtë vijon: Vendimi Asamblesë datë 04.04.2017 shoqëruar me vulën apostile Nr. 1742, datë 21.04.2017, Prokurën Speciale hartuar nga Noter Giovanni PANZERA, prokurë e pajisur me Vulën Apostile Nr. 1743, datë 21.04.2017, dokumente të lëshuara organet shtetërore të Italisë, karta e identitetit të përfaqësuesit me procure, dokumentet e identifikimit të palëve të tjera, ekstrakti i shoqërisë “Il Progetto” Sh.p.k. ekstrakti i shoqërisë “Babasi Co” Sh.p.k.

NENI 10 PËRKTHIMI



Duke qenë se pala shitëse nuk kupton gjuhën shipe kjo kontratë fjal për fjalë ju përkthye shtetasve Italian nga Përkthyes Znj. Anila BERBERI e identifikuar nëpërmjet letërnjoftimi elektronik Nr. Personal: H25815062P, me NIPT: L21815002P, përkthyes e njohur nga Ministria e Drejtësisë së Republikës së Shqipërisë.

NENI 11 DISPOZITA E FUNDIT

Kjo kontratë u hartua nga dhe midis palëve të kësaj kontrate me dëshirë të lirë dhe të pavesuar të palëve të kësaj kontrate si dhe bazuar në legjislacionin shqiptarë në fuqi. Mosmarrëveshjet që mund të lindin nga kjo kontratë do të zgjidhen me mirëkuptim midis palëve ndryshe palët do ti drejtohen gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Kjo kontratë U lexua nga palëve dhe pasi palët lexuan edhe vetë këtë kontratë kuptuan se përmbajtja e saj është e njëjtë me dëshirën dhe me vullnetin e tyre të lirë dhe të pavesuar, kështu që kjo kontratë nënshkruhet nga palët e kësaj kontrate në prani të njëri tjetrit në çdo faqe të kësaj kontrate. Me kërkesën e palëve kjo kontratë hartohet në 7 kopje origjinale me të njëjtën përmbajtje ligjore, në 6 faqe, pala shitëse secili prej tyre mban nga një kopje dhe pala shitëse merr secili nga dy kopje origjinale. Duke qenë se se kjo kontratë është në pajtim të plotë me dëshirën dhe me vullnetin e palëve si dhe me ligjin në fuqi nënshkruhet rregullisht nga palët duke bërë kalimin e pronësisë së kuotave sipas dhe në përputhje me nenin 4 të kësaj kontrate

PALËT KONTRATUESE

PALA SHITËSE

me Zev Berber
me prokuror
Korç. Berber
Korç. Berber

me Domenico Micoccheri
me prokuror

Korç. Berber
Korç. Berber

Korç. Berber
Korç. Berber

PALA BLERËSE

~~Osman Rashid~~
Tahir Babase



PËRKTHYES

Anila Berberi

